



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.614 Prot.

Tiranë, më 19 .05. 2023

V E N D I M

Nr.75 , Datë 19.05. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 142 Regj, datë 16.09.2022, paraqitur nga znj. M.Ll kundër z. A.S , Kryetar i Bashkisë Cërrik, z. F.D, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Cërrik dhe znj. M.Xh , Drejtore e Burimeve Njerëzore, Bashkia Cërrik, me pretendimin për diskriminim për shkak të *gjendjes arsimore dhe moshës*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja M.Ll deklaron se, është e datëlindjes 08.12.1966, është punonjëse e Bashkisë Cërrik, ku ka filluar punë në vitin 1997 dhe ka punuar në pozicione të ndryshme, si inspektore pagave, inspektore taksave, inspektore pastrimit, inspektore pronave shtet, përgjegjëse pronave, përgjegjëse në njësi. Aktualisht, mban detyrën përgjegjëse e pronave. Ajo shpjegon se, ka mbaruar dy fakultete për ekonomi, para dhe pas viteve 1990.

Ankuesja parashtron se, nga fillimi i vitit 2021, Sekretari i Përgjithshëm z. F.D, bënte mbledhje me presion për disiplinën dhe orarin e punës. Në fillim të qershorit 2021, bëhet mbledhja e radhës, gjatë të cilës, në sy të kolegëve, ankuesja është shprehur gjatë mbledhjes që të mos ju bëhej presion punonjësve dhe se kishte punonjës të cilët kishin vite që nuk vinin në punë. Duke mos i pëlqyer një gjë e tillë, z. D, urdhëroi punonjësit e policisë bashkiake që ta nxjerrin me forcë ankuesen nga mbledhja, edhe pse nga mosha ajo ishte nëna e tij. Për këtë ngjarje ankuesja ka bërë denoncim në polici, e cila i ka kaluar aktet në organin e prokurorisë. Prokuroria ka mbyllur këtë çështje me

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

vendimin nr. 380, datë 08.07.2021. Pas këtij denoncimi të bërë në polici, për dhunë verbale dhe fizike në mbledhje me rreth 90 punonjës të bashkisë, ajo është sulmuar padrejtësisht nga Sekretari i Përgjithshëm, z. F.D. Pas nxjerrjes me forcë nga mbledhja, ankuesja është urdhëruar që të lëviz me zyrë, nga kati i dytë për në katin e parë të bashkisë. Duke pretenduar se kjo ishte e padrejtë, ankuesja ka bërë një ankesë pranë Kryetarit të Bashkisë. Pavarësisht se ishte në pritje të një përgjigje nga ana e tij, zyra e saj është hapur natën me forcë, dhe materialet e saj të zyrës, pa prezencën e saj, janë zhvendosur në katin e parë. Ankuesja kishte vetëm një vit që e kishte ndryshuar zyrën me qëllim që të ishte më afër Drejtorisë së Financës, ku edhe bën pjesë.

Për t'a penalizuar dhe për të vështirësuar situatën e saj, ankuesja shprehet se, Sekretari i Përgjithshëm, ka depozituar në prokurori kallëzim, duke pretenduar për dëmtim të pronës së bashkisë apo histori të tjera të sajua. Për këtë kallëzim, ankuesja deklaroi se ka marrë dijeni vetëm kur është thirrur në tetor nga prokuroria, e cila në përfundim ka hedhur poshtë këto pretendime me anë të vendimit nr. 16999, datë 02.11.2021.

Më pas ankuesja deklaroi se, ndaj saj ka filluar procedimi disiplinor për mosparaqitje në punë. Pavarësisht se ajo depozitoi një sërë provash, si urdhër pune nga Kryetari i Bashkisë, sigluar edhe nga Sekretari i Përgjithshëm, pamje të librit në hyrje dalje të bashkisë, foto të vendit ku kishte punuar në terren, emrat e punonjësve që kishin punuar me të ato ditë, Komisioni Disiplinor i ka dhënë vërejtje, në mënyrë të padrejtë, vetëm pasi kjo ishte dëshirë e Sekretarit të Përgjithshëm. Ankuesja ka kundërshtuar vendimin e Komisionit Disiplinor për dhënën e vërejtjes pranë Komisionerit të Shërbimit Civil, i cili u shpreh se procedura e ndjekur nga bashkia ishte e drejtë.

Gjatë kohës që vendimi i Komisionerit të Shërbimit Civil nuk ishte zbardhur, në tetor 2021, ankuesja ka konkuruar për një vend pune si drejtor tatimesh. Pas vështirësive për dhënien e dokumentacionit për të aplikuar, nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, ankuesja është skualifikuar pasi kishte vërejtje, edhe pse vendimi i Komisionerit të Shërbimit Civil nuk ishte zbardhur.

Në vazhden e veprimeve hakmarrëse, ankuesja shprehet se, u transferua në mënyrë jo ligjore në Njësinë e Shalës. Pozicioni i punës ku do të transferohej nuk kishte kaluar në këshill Bashkiak dhe nuk ishte brenda drejtorisë së financës ku ajo punon, por në drejtori tatimesh. Urdhri i transferimit nuk u ekzekutua, se kaluan afatet nga koha e kundërshtimit që ajo kishte bërë pranë Kryetarit të Bashkisë.

Në nëntor 2021, ankuesja deklaroi se ka ndodhur një incident, me punonjësen S.O., e cila kishte filluar punë në sektorin e ankueses, në mars 2021. Kjo punonjëse, e cila kishte histori të mëparshme dhune në punë, pasi kishte dhunuar dy punonjës të tjerë të Konviktit, ka ushtruar dhunë ndaj ankueses. Për këtë fakt, ankuesja ka paraqitur ankesën e saj për marrjen e masave ndaj kësaj punonjëse pranë Kryetarit të Bashkisë. Pavarësisht kësaj ankese, ndaj punonjëses nuk u mor asnjë masë ndëshkuese, por vetëm se u transferua në një pozicion tjetër pune dhe ankuesja nuk mori asnjëherë asnjë përgjigje në lidhje me ankesën e bërë.

Në datën 15.11.2021, ankuesja ka paraqitur një kërkesë me shkrim drejtuar Kryetarit të Bashkisë, në të cilën ka kërkuar rishikimin e urdhërit për masën disiplinore dhe ngritjen e komisionit me anëtarë të rinj, pasi drejtorët ishin klasifikuar me dëme të mëdha nga KLSH. Pas një sorrollatje prej 6 muajsh, në datën 31.05.2022, ankuesja ka marrë një përgjigje në të cilën informohej se bashkia ishte shprehur njëherë.

Në janar 2022, menjëherë pas pushimeve të vitit të ri, ankuesja deklaroi se është dërguar për të mbledhur taksat dhe ishte e vetmja punonjëse që nuk kishte lidhje me taksat, ndërsa gjithë punonjësit e tjerë i përkisnin këtij sektori, për më tepër duke i vendosur një punonjës të policisë bashkiake (policin A.M) për të ruajtur ankuesen.

Në maj 2022, fillon një presion mbi administratën (orari 9-12, 12-1 pushim, 1-18 në punë), i pabazuar në ligj dhe rregullore. Kjo u kundërshtua me gojë nga ana e drejtorëve të bashkisë, por jo nga Drejtori i Burimeve Njerëzore. Në lidhje me këtë situatë ankuesja deklaroi se ka bërë ankim pranë Komisionerit të Shërbimit Civil. Sekretari i Përgjithshëm u justifikua se kishte vendosur disa ndryshime në rregullore, ku asnjë nga drejtorët nuk dinin gjë.

Pas këtij momenti, ankuesja shpjegon se, filloi të përsëritet situata e ndodhur në qershor 2021. Konkretisht, në datën 02.06.2022 me urdhër të Kryetarit të Bashkisë ajo është urdhëruar të dilte nga godina dhe të vendosej me zyrë te ambientet *One Stop Shop* ku janë punonjësit që kanë shërbimin me qytetarët. Edhe në zyrat e reja, ka vazhduar dhuna psikologjike dhe verbale duke marrë 4 herë në ditë mungesat, vendosja e policëve në bashki që ankuesja të mos hyjë, si dhe heqja e ditëve të punës edhe duke qenë në korridor ose në banjë. Sipas saj shkresat dhe procesverbalet janë bërë me punonjës që janë dhe ishin në Angli, ose që nuk vijnë në punë.

Në lidhje me transferimin e zyrës, ankuesja deklaroi se ka bërë ankesë pranë Kryetarit të Bashkisë, duke pretenduar se transferimi është urdhëruar në kundërshtim me ligjin, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Ankuesja është detyruar që të lëvizë në zyrën e re, ku është transferuar, por kjo gjë e pengon në kryerjen e detyrave të saj. Ankuesja shprehet se ndaj saj ka filluar ecuria disiplinore për mosparaqitje në punë dhe moszbatim të urdhrit të titullarit, që në datën 13.06.2022. Në vijim, nëpërmjet e-maileve ankuesja është njoftuar për shtyrje të procedurës pa shkak të ligjshëm. Në datën 08.09.2022 ankuesja ka marrë njoftimin e fundit në lidhje me ecurinë disiplinore.

Ankuesja parashtroi se, me formimin e 61 bashkive, u hapën vende të reja pune, në të cilat ajo shprehu interesin e saj, por është penguar në mënyra të ndryshme për të marrë këto pozicione, sipas saj edhe për shkak të moshës pasi në bashki i quajnë plaka. Konkretisht, këto pozicione pune janë: vendi i auditit, ndërkohë që punonjësit që u morrën ishin pa status dhe pa certifikata; vendi për drejtorë tatimesh, për të cilin edhe pse paraqiti ankim tek Komisioneri i Shërbimit Civil, nuk i është komunikuar asnjë herë përgjigje që erdhi në bashki; vendi i punës si drejtor tatimesh, për të cilin nuk u pranua me pretendimin se kishte vërejtje të lehtë, sipas saj të dhënë në mënyrë të padrejtë. Sipas ankueses, aktualisht, pozicioni drejtor tatimesh, është bosh dhe personi që punon aktualisht si drejtor, është me vërejtje të rëndë dhe është fotografuar gjatë orarit të punës në fushatë zgjedhore.

Ankuesja deklaron se, Sekretari i Përgjithshëm e pengon për t'u ngritur në detyrë duke i dhënë vërejtje të pabazuara. Pozicionet i'u jepen punonjësve pa sistem karriere, pa meritë. Po të hapen dosjet dalin 80 % e bashkisë që janë marrë në mënyrë të paligjshme dhe vazhdojnë dhe merren në mënyrë të paligjshme. Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, e ka rimarë vendin pa konkurs dhe nuk ka arsimin përkatës. Drejtoresha e Burimeve Njerëzore nuk mbron punonjësit, por në mënyrë jo ligjore bëhet vegël, duke kërcënuar se do të largojë ankuesen nga bashkia.

Ankuesja pretendon se të gjitha veprimet organizohen nga Sekretari i Përgjithshëm, z. F.D, i cili ka përgjegjësi pavarësisht se nuk ka firmën e tij, ndërsa përgjegjësia e znj. M.Xh qëndron në faktin se ajo bën dhe firmos çfarë i thonë dhe z. A.S , Kryetari i Bashkisë, nuk merr asnjë masë, por firmos çfarë dokumentesh i çojnë.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri që të fillojë një hetim administrativ, duke mundësuar një ballafaqimin midis palëve, dhe në përfundim të tij, marrjen e masave të mëposhtme:

- Të mos dhunohet fizikisht, verbalisht dhe psikologjikisht;
- Të mos na quajnë plaka dhe që nuk duan të na shohin në bashku;
- Rishikimin e masës administrative që është marrë ndaj saj në mënyrë të padrejtë;
- Të mos pengohet me sajesa vërejtjesh për të marrë pozicione pune;
- Të rikthehet në zyrën që ka patur pranë Drejtorisë së Financës, ku bën pjesë për të mos penguar funksionimin e punës;

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma "a", të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke garantuar mbrojtje të drejtëpërdrejtë nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës nr.142 datë 16.09.2022, rezultoi se ajo nuk ishte e plotë për të vijuar më tej shqyrtimin e saj. Me anë të e-mailit datë 03.10.2022, ankueses iu kërkua plotësimi i ankesës, veçanërisht në drejtim të përcaktimit të qartë të subjekteve kundër të cilëve drejtohet ankesa, si dhe shkaqeve të pretenduara të diskriminimit. Me shkresën nr.1211/3 prot., datë 10.10.2022, ankuesja depozitoi pranë Komisionerit informacionin plotësues në lidhje me ankesën.

Pas plotësimit të ankesës, në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 1211/4 prot., datë 20.10.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa, në lidhje me pretendimet e parashtruara nga pala ankuese në ankesë. Me shkresën nr. 2976/1 prot., datë 28.10.2022³, Bashkia Cërrik ktheu përgjigje duke parashtruar ndër të tjera:

Është e vërtetë që znj. M.Ll është s'kualifikuar nga procedura për ngritje në detyrë. Arsyet e skualifikimit nuk janë për shkak të gjendjes arsimore dhe moshës. Bashkia Cërrik në datë 02.09.2021 ka publikuar shpalljet, ndër të tjera për procedurën për ngritje në detyrë në vendin vakant të Drejtorit të Drejtorisë së të Ardhurave. Ankuesja ka aplikuar për këtë shpallje dhe në bazë të shkresës bashkëlidhur është njoftuar për mos kualifikimin për fazën tjetër të konkurimit për arsye se ka një masë disiplinore në fuqi. Ankuesja ka marrë njoftim duke sigluar shkresën.

Masa disiplinore e dhënë ndaj znj. Ll është marrë në vijim të procedurës disiplinore të ndjekur nga Komisioni Disiplinor (KD), i ngritur në bazë të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen e komisionit disiplinor*”, me urdhër nr. 117, datë 29.06.2021 “*Për ngritjen e Komisionit Disiplinor*” me objekt shqyrtimin e shkeljeve të konstatuara për punonjësen M.Ll , ka qenë i përbërë nga 5 anëtarë: M. Xh.-Kryetare, S.A.- anëtar, F.U. - anëtar, C.Sh. – anëtar dhe H.K.– anëtar. Mungesa e nëpunësit më të lartë civil në institucion, që është Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Cërrik, është për shkak të kërkesës së tij regjistruar me nr.1455/1 prot., datë 14.06.2021, drejtuar Kryetarit të Bashkisë, ku deklaroi pamundësinë për të marrë pjesë në përbërjen e KD, pasi ndodhet në konflikt interesi për shkak të pretendimeve të ankueses, si dhe duke respektuar paanësinë dhe krijimin e kushteve të vendimarrjes larg çdo dyshimi për palën ndaj të cilës pretendohet shkelja, kërkesë kjo e miratuar nga Kryetari i Bashkisë.

KD, ka bërë njoftimin e nëpunëses dhe ka lënë datë zhvillimi të seancës datën 06.07.2021. KD në vendimin nr. 06, datë 06.07.2021, është shprehur se, shkelja qëndron, por duke e klasifikuar atë si shkelje të lehtë të disiplinës mbështetur në pikën 1/c të nenit 57 “*Përgjegjësia për masën disiplinore*”, në gërmën “a”, të nenit 58 “*Llojet e masave disiplinore*” dhe në pikën 1, të nenit 59 “*Kompetencat për masat disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, i është dërguar për kompetencë eprorit direkt, i cili me urdhër nr. 06/1, datë 06.07.2021, ka dhënë masën disiplinore vërejtje, për ankuesen. Nga ana e znj. M.Ll nuk është bërë ankim gjyqësor për kundërshtimin e aktit, por është bërë ankim pranë Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil,

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1211/5 prot., datë 02.11.2022.

ankim i cili ka rezultuar i pabazuar. Me vendimin nr. 133, datë 28.10.2021 “Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procedurës disiplinore përfunduar me masën “Vërejtje” të nëpunëses M.Ll me detyrë “Përgjegjëse në Sektorin e Regjistrimit dhe Inventarizimit”, ndër të cilat theksohet: “nga gjithë sa u theksua më sipër, nisur nga përmbajtja e dokumentacionit në të cilat materializohet procedura disiplinore, arrihet në konkluzionin se, si nga pikëpamja procedurale ashtu dhe ajo materiale, janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit...”. Me anë të këtij vendimi është konfirmuar masa disiplinore e dhënë nga Bashkia Cërrik, e cila bazuar në nenin 61, të ligjit nr. 152/2013 “Për shërbimin civil”, të ndryshuar “Shuarja e masave disiplinore”, pika 1, shuhet pas kalimit të 2 viteve. Për sa më lart, skualifikimi i ankueses nga konkurimi është bërë për shkak ligjor, i konfirmuar gjithashtu nga KMSHC dhe jo në kushtet e gjendjes arsimore apo të moshës.

Formimi i 61 bashkive është bërë në 2015 dhe me nr. 2749 prot., datë 02.11.2016 znj. Ll është emëruar në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Shtetërore. Në asnjë rast në historinë e Bashkisë Cërrik nuk ka asnjë dokumentim apo pretendim për diskriminim për shkak të moshës. Ashtu siç thekson edhe ankuesja, me formimin e 61 bashkive në vitin 2015 u hapën pozicione të reja pune, kjo për shkak të riformatimit duke shpallur vende vakante sipas rastit. Në njërin nga këto procedura ka konkuruar dhe znj. M.Ll duke fituar pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Shtetërore, e dokumentuar me aktin e emërimit nr. 2749 prot., datë 02.11.2016, si dhe dërgimi për publikimin e njoftimeve të fituesit në konkurimet e zhvilluara në Bashkinë Cërrik me shkresën nr. 1476/1 prot., datë 24.04.2017. Në këtë periudhë që ankuesja ka marrë emërimin ka qenë i njëjti Sekretar i Përgjithshëm në Bashkinë Cërrik. Sa më lart rrëzohet pretendimi i ankueses për këtë pjesë të ankimit. Nuk ka asnjë element të pengesave të asnjë tipi për shkak të moshës, në një bashki të vogël, në një zonë ku mosha mesatare është në rritje për shkak të emigrimit.

Gjithashtu, me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 370, datë 21.12.2018 ankuesja ka marrë pagën maksimale të shtesës për pozicion, të cilën vazhdon ta përfitojë edhe sot. Ky element tregon se nuk ka pengesa të asnjë tipi që lidhen me moshën, në një bashki të vogël në një zonë ku mosha mesatare është në rritje për shkak të emigrimit. Për të demonstruar faktin se elementët të diskriminimit për shkak moshe nuk ekzistojnë në Bashkinë Cërrik, bashkëlidhur po ju dërgojmë listën e punonjësve e nëpunësve të bashkisë, me moshën mbi 50 vjeç, ku nga më pak se 200 punonjës pjesë e funksioneve të bashkisë, rreth 108 prej tyre janë mbi 50 vjeç. Ndër ta renditen 3 drejtorë me status të nëpunësit civil mbi këtë moshë, në 5 drejtorë gjithsej që ka Bashkia Cërrik.

Bashkia Cërrik nuk disponon prova apo ankesa të tjera për punonjësen S.O., përveç asaj të ankueses, ku pretendohet ushtrim i dhunës nga ana e kësaj punonjëseje ndaj ankueses. Nga ana e ankueses është paraqitur një ankesë me nr. 5103 (ose 5113), datë 22.12.2021, në të cilën theksonte se vartësja e saj S.O., ushtroi në datë 22.12.2021 dhunë në vendin e punës. Po kështu, nga ana e punonjëses S.O. në datë 22.12.2021, është paraqitur një kërkesë drejtuar Kryetarit të Bashkisë nr. 5108 prot., datë 22.12.2021, në të cilën ndër të tjera thekson se, është nën trysni dhe bullizëm të vazhdueshëm nga ana e përgjegjëses së saj dhe rasti i fundit është në datë 22.12.2021, ku për rreth 1 orë është ofenduar nga ana e përgjegjëses së saj si dhe duke bërë me dije se, ka një vend të lirë

pune në NJA Klos (rreth 4 km nga vendi aktual i punës). Nga ana e Kryetarit të Bashkisë i është kërkuar informacion Policisë Bashkiake, e cila ka zyrën pranë zyrës ku punon ankuesja, nëse ishin konstatuar elementë të dhunës dhe a ka patur kërkesë për ndihmë apo debate me tone të larta. Nga ana e Policisë Bashkiake është referuar se nuk ka patur asnjë rast ankese prej asnjë prej palëve apo kërkesë të çfarëdolloji dhe pse kanë qenë shumë afër dhe policët e shërbimit kanë qenë në dispozicion në kat të parë të objektit. Në vijim, Kryetari i Bashkisë ka pranuar kërkesën e punonjësës S.O. duke e transferuar në detyrën e specialistes së terrenit në vjeljen e të ardhurave NJA Klos, ku punon dhe aktualisht me urdhrin nr.11, datë 12.01.2022.

Me urdhër nr.130, datë 15.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë, është vendosur ndryshimi i orarit të punës duke ndryshuar nenin 31 të Rregullores së Brendshme, të Bashkisë Cërrik. Kompetencat ligjore për këtë rast janë në bazë të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, neni 40 dhe VKM nr. 568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimit të tyre, në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, kreu II, pika 2/b. Gjithashtu në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, germa “j” theksohet: “Kryetari i Bashkisë miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njërive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi”. Nëpërmjet shkresës nr.447/3 prot., datë 07.07.2022 të KMSHC theksohet: në rastin konkret, akti 130, datë 15.04.2022 “Për ndryshimin e orarit të punës së administratës dhe ndryshimin e nenit 31 të rregullores së brendshme organizative të Bashkisë Cërrik”, në të cilin është ndryshuar orari i punës, vlerësohet se është nxjerrë në përputhje me ligjin.

Znj. M.LI në asnjë rast nuk është urdhëruar të dilte nga godina. Në bazë të urdhrin nr.229, datë 02.06.2022 të Kryetarit të Bashkisë, për eficientë e shërbimeve, zhvendosen 2 sektorë të bashkisë në godina të ndryshme, në largësi 150 m nga njëra tjetra. Me sektorë duam të theksojmë sektorin e inventarizimit dhe regjistrimit të pronave publike, me 3 punonjës në godinën e *One Stop Shop* dhe Sektorit Social me 2 punonjës.

Në rastin konkret me urdhrin nr. 229, datë 02.06.2022 të Kryetarit të Bashkisë, kemi të bëjmë me një lëvizje fizike zyrash në një zyrë (ambient) i bashkisë në zyrë (ambient) tjetër të bashkisë, duke respektuar të drejtat e largësisë (aktualisht 150 m nga ambienti aktual, legjislacioni për NC, e kufizon largësinë në 45 km, neni 48, pika 3, germa “b”, të ligjit nr.152/2013, duke respektuar detyrimin e institucionit për krijimin e kushteve normale të punës (ambienti është i bollshëm, me ndriçim, me të gjitha pajisjet e nevojshme, kompjuter, tavolinë pune etj). Pra, për sa më lart nuk ka asnjë ndryshim të kushteve të punës, asnjë emërtim, asnjë ndryshim funksionesh apo page. Ambientet e punës, institucioni i përshtat në funksion të mbarëvajtjes së punës së përditshme, duke respektuar të drejtat e punonjësve të sipërcituar. Pra, nuk kemi asnjë shkelje ligjore apo pengesë në kryerjen e detyrave funksionale të ankueses. Pas kësaj procedure normale pune, ankuesja nuk është paraqitur në punë për 3 ditë, duke pretenduar se pret ankesën drejtuar kryetarit të bashkisë për paligjshmërinë e urdhrin. Përpos pretendimeve në lidhje me urdhrin e kryetarit të bashkisë, ankuesja nuk është paraqitur në punë dhe për këtë arsye nga ana e eprorit direkt, Drejtorit të

Drejtorisë së Financave dhe Pronave Publike, z.H.K, është bërë një kërkesë drejtuar KD, të Bashkisë Cërrik, për nisjen e procedurës disiplinore. Nga ana e kryetarit të bashkisë është ngritur KD me urdhër nr.357, datë 08.09.2022, dhe pas këtij, njoftimi për nisjen e procedurës disiplinore me nr. 2572 prot, datë 08.09.2022. Duke qenë se procedura disiplinore në fjalë është në proces nuk mund të shprehemi në lidhje me të. Në procesin fillestar janë zbatuar dispozitat e përcaktuara nga ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe po në këtë mënyrë, do të vazhdohet me procedurat e vendimin e marrjes së KD.

Me shkresën nr.1759 prot., datë 31.05.2022 znj. M.Llështë informuar se, Bashkia Cërrik në përgjigje të ankimimit është shprehur një herë në lidhje me këtë procedurë. Gjithashtu znj. M.Llështë informuar dhe për vërtetimin nr.3925 prot., datë 10.09.2021, ku dokumentohet se, asnjë nga anëtarët e KD nuk kanë marrë masë disiplinore.

Me urdhër nr. 92, datë 08.06.2022, ndër 47 punonjës gjithsej, është informuar edhe znj. Ll për sistemimin e zyrave, në të njëjtën godinë të Bashkisë Cërrik. Në mbledhjen normale të punës së zhvilluar ditën e nesërme, duke qenë e pakënaqur me spostimin e zyrës, siç dhe u konstatua më pas, ankuesja krijoi një anomali në funksionimin normal të një mbledhje, duke ngritur zërin dhe duke penguar funksionimin normal të një mbledhje. I është kërkuar punonjësës të dalë nga mbledhja, pasi po bëhej e pamundur funksionimi normal i saj dhe në asnjë rast punonjësja nuk ka patur as largim me forcë dhe as prekje nga punonjës të policisë bashkiake, të cilët po ashtu kanë qenë pjesë e mbledhjes. Znj. Ll ka kundërshtuar me fjalë largimin, duke krijuar një situatë jo normale për fugurën e një nëpunësi, por më pas ka dalë vetë nga mbledhja.

Më pas ne kemi marrë dijeni se punonjësja ka bërë denoncim dhe nga dokumentimi përkatës, thirrja e dëshmitarëve prezent në mbledhje dhe të gjithë rrethanës, nuk ka patur një mbyllje nga ana e prokurorisë siç pretendon ankuesja, por ka patur një mosfillim pasi nuk qëndronte kallëzimi i saj.

Në vijim, ankuesja e tensionon situatën në bashki, duke mos zbatuar urdhrin për risistemimin e zyrave, duke u sjellë kështu pa shkak e pa një justifikim të ligjshëm, e duke u bërë pengesë për funksionimin e punës në sektorin e saj, por edhe të pjesës tjetër të administratës. Nga ana e Policisë Bashkiake është dokumentuar e gjithë situata, kjo në zbatim të funksioneve të saj përcaktuara nga ligji për policinë bashkiake, ku përfshihet ruajtja dhe siguria e pronave të bashkisë, ndërkohë që me komision është kryer dhe spostimi i zyrave përkatëse.

Në këto kushte, theksojmë se ankuesja pa asnjë justifikim ligjor, nis të spostojë mobiljet e zyrës të cilat janë pronë e bashkisë, duke përplasur e thyer ndër të tjera dhe një karrige të punës, e duke e rikthyer në ambientet e mëparshme. Policia Bashkiake, dhe jo Sekretari i Përgjithshëm, në detyrim të ligjit, kanë bërë kallëzim penal. Është e vërtetë që me shkresën nr.1699 prot., datë 03.11.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka vendosur përfundimin e hetimeve duke cituar: “*Organi procedues vlerëson se, në rastin konkret nuk plotësohet elementi i anës objektive të figurës së veprës penale, pasi në rastin konkret dëmtimi i pronës është kryer me dashje, por pasoja materiale, prej 500 lekë, është e një natyre jo të rëndë*”.

2. Me anë të e-mailit të datës 13.11.2022, ankuesja ka dërguar prapësimet e saj në lidhje me shkresën e sipërcituar të Bashkisë Cërrik, duke parashtruar ndër të tjera se⁴:

Si gjithmonë Sekretari fshihet me firmën e Kryetarit e të tjerëve.

1. *Në lidhje me vërejtjen e dhënë nga Komisioni Disiplinor në datë 06.07.2021*

Bashkia gënjen (metoda e shkrimit, mendimit është e Sekretarit Përgjithshëm, pasi ka bashkëngjitur disa shkresa të marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore). Në lidhje me procedurën edhe pse kërkova nuk mu dhanë: materiali hetimor, proces-verbali i mbajtur, pamjet e kamerave në hyrje të bashkisë, nuk u pyetën punonjësit që unë punova në terren, shënimet në rregjistrin e hyrjeve të bashkisë (kur dalim në terren). Nuk pati material hetimor edhe në komisionin disiplinor. Asnjë pjestar i komisionit, edhe unë, nuk kishim materialin hetimor sipas ligjit nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Shkresat i bën vetë dhe i firmosen po vetë. Drejtoria e Burimeve Njerëzore u shpreh, ta mbyllim shpejt, duke nxjerrë një vendim fiktiv të Komisionit të Disiplinës, kjo pasoi me dhënien e vërejtjes, firmosur nga Kryetari i Bashkisë, pa marrë parasysh pikat e paraqitura më lart. Materiali hetimor është kërkuar, që nga dita e mbledhjes së Komisionit Disiplinor dhe nuk është dhënë sot e kësaj dite.

2. *Në lidhje me pikën e dytë.*

Shikohet nga shkrimi si Sekretari shfaqson veten e vet, duke pretenduar se ka bërë favore, me të drejtat që jep ligji. Marrja e postit të Përgjegjës, është bërë në mënyrë ligjore dhe dokumentat përkatëse dhe rritja e pagesës është bërë sipas ligjit përkatës të nëpunësit civil. Këto i kam fituar me 26 vjet pune vetëm në Bashkinë Cërrik, nëpërmjet edukimit arsimor (kredite, pikë nga provimet, mbase më shumë se Sekretari apo dhe drejtorët e tjerë në Komisionin Disiplinor) dhe performancën në punë.

Unë kam konkuruar për vende “Drejtori” dhe në këtë grup moshë nuk është ashtu. Ne kemi këto drejtori: Drejtori Financës ishte, nuk u mor në punë;- Drejtori Urbanistikës, ishte; - Drejtori Bujqësisë, erdhi me transfertë nga Ministria (Pyjeve); - Drejtore Burimeve Njerëzore, u hap i ri vendi (e re); - Drejtore Projekteve, u hap i ri vendi (e re); - Drejtore Kabinetit, u hap i ri vendi (e re); - Drejtor Shërbimesh, u hap i ri vendi (i ri); - Sekretari Përgjithshëm, u hap i ri vendi, (e ri). Pra nuk është ashtu (nuk konkuroj për sanitare, magazinjere e profesione të tjera të nderuara). Krahasimi bëhet me grupin ku konkurron.

3. *Në lidhje me orarin.*

Në kohën që Sekretari ndërroi orarin. Ne kërkonim urdhrin e Kryetarit Bashkisë. Drejtorët deklarorin se urdhërin nuk e japim, se konsideroheshë si konfidenciale. Si ishte orari konfidencial? Vendimin e Këshillit Bashkiak, për ndryshime në orar nuk e dinin as Drejtorët dhe jo punonjësit. Kur bëhen ndryshime, ato duhet t'i dimë edhe ne pa kaluar në Këshill Bashkiak, se ne jemi grup interesi, prekemi nga kjo gjë. Në mbledhje Sekretari kërkonte punonjësin se kush ishte ankuar. Nuk

⁴ Pretendimet janë pasqyruar sipas citimeve të vetë ankueses.

dha bazën ligjore për orarin. Presion për atë që u ankua. Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe pse nuk doli në mbrojtje të punonjësve, fliste në bashki se e kisha bërë unë ankesën. Thyerje e konfidencialitetit midis institucioneve. Vendimin e Këshillit Bashkiak për ndryshimin, e kishte kollaj se: (Mazhoranca ka Kryetarin, Këshillin, Prefektin, nuk është e vështirë ti bësh dhe korigjosh). Presion për atë që u ankua. Këto dhe të tjera tregojnë se, Sekretari i Përgjithshëm është, mashtrues, gënjeshtar, intrigant dhe në çdo rast, argumenti, justifikimi i tij është se nuk ka firmosur letrat. Gjithmonë mbrohet me firmën që s'është nevoja ta vërë vetë, sepse ka me dhjetra "vegla" që nuk vijnë në punë dhe i përdorë si do vetë. Ai dhe pa firma është fajtor sepse i ka detyra funksionale. Nga fuqia vjen pas Kryetarit të Bashkisë.

4. Në lidhje me punonjësen S. O

Që në emërim është në kundërshtim me ligjin. Vendi punës ka kaluar në Këshill Bashkiak ku specifikohet si vend me status të Nëpunësi Civil. Punonjësja nuk ka as statusin dhe as bëri konkurim për vendin e punës. I kishin thënë: Rri atje. Reagimi i saj për punë ishte katastrofë. Ankesa e saj ka shkrimin dhe mëndjen e Sekretarit dhe është bërë pas ankesës time (si shpjegohet?). Pse nuk u ankua më parë? U ankua kur ju dha punë për të bërë (nuk përdor as programe bazike si word dhe excel). E vetmja punë që mund ti jepje ishte të fotokopjonte, por edhe për atë nuk donte të punonte, dhe përdori forcën. Unë kërkoja ballafaqim (nuk mu bë). Ankesa e saj nuk mu bë me dije më parë. Tani po e marr vesh. Më është kërkuar nga njerëzit e saj ta falja, dhe nga Drejtori Financës. (Zonja e kishte përdorur forcën edhe në punët e tjera që kishte bërë, përmendim atë në konvikt.) Kërkova të pyeteshin punonjësit, por nuk e bënë (nuk do sekretari). Unë e kam trajtuar me njerzillëk, por fakti që përdori dhunë, duhet të mbroheshe duke shpifur (sekretari do mbronte veglën e vet). Kërkova ndihmë nga Policia Bashkiake, me thanë nuk marim urdhra nga ty (Policinë Bashkiake e përdori edhe në denoncimin në prokurori) I bën Sekretari dhe vendos çfardo emri që përdor. (Çfarë do presësh).

5. Në lidhje me lëvizjet nga zyra, jo një herë por sa herë të doje ai.

Më vinin shpesh policët bashkiak për të dalë nga godina. Kishin bërë edhe urdhër, për të dalë nga zyra dhe godina. Megjithëse unë u dhashë ligjin në të cilin prisja konfirmimin e Kryetarit të Bashkisë, sipas ligjit "Për nëpunësin civil", neni 43, pika 3. Këtë ligj ja çova në zyrë edhe Dr. Burimeve Njerëzor, e cila nuk e pa dhe tha: "Ligji jam unë, ligji është Kryetari Bashkisë".

Pra gjatë këtyre 2-3 ditëve, që pretendonin që unë nuk jam paraqitur në punë (kanë qenë policat që me rrinin mbi kokë, Dr. Burimeve Njerëzore që ishte afër zyrës ku punoja unë dhe thëriste boshatis zyrën, Drejtori Financës që e pranon që në këto ditë kam qenë në bashki qëndër, por jo në njësi (unë nuk mund të jem në dy vende njëkohësisht). Kamerat në hyrje të bashkisë të përdoren si provë që prania ime është e faktuar në godinën qendrore. Punonjëset e punës sociale erdhën 4 vetë dhe nuk i zinte zyra që kisha unë. Pra, nuk kishin kushte, nuk funksiononte puna. Pra, se bëri për ambiente dhe funksione? Lëvizjen e bëri për mua. Pas disa ditësh ato u kthyen në godinën e One Stop Shop (njësi) dhe unë nuk u ktheva në zyrën që ato liruan (aty është futur punonjëse shërbimesh pastrimi, muratore) që nuk duhet të ketë zyrë. Ligji thotë krijo kushte për punonjësit me status nëpunësi civil, jo atij me Kod Pune. Në sektorin tim unë jam vetëm. Kur më ndryshuam

godinën të dy punonjësit u larguan pasi dhe emërimet i kishin bërë kundër ligjit (ishin pa status, pa konkurs). Nga frika ankesës sime i larguan në punë të tjera. Mendoni si është e tërë bashkia. Të dy palët që lëvizën zyrat, nuk kërkuan asnjëherë ambiente, pasi puna na funksiononte mirë.

Për sa i përket kushteve gënjen, po shumë. Mua nuk më largoi nga bashkia jo për të më dhënë kushte por të më mërzisë dhe largoj nga puna. Jam vetëm, me ndriçim nga drita e zotit, pa ngrohje kondicioner (këtu në njësi vetëm zyra ime nuk ka kondicioner), nuk të japin as reflektor për ngrohje edhe pse kam kërkuar. Kompjuteri ka 16 vjet me difekt. Për vete marrin kompjutera të rinjë, çdo vit. Më e keqja është se nuk më japin bojë për printer (sekretari thotë sa të jem unë nuk ke bojë printeri). Edhe për prokurimet, tenderat firma nuk vë por i bën ai me firmat e komisioneve. Blerjen e materialeve e bënë Sekretari.

6. Pas lëvizjes së zyrës Sekretari do vazhdonte me skenarin (Dr. Burimeve Njerëzore tha lëviz nga zyra shpejt se do kalohet në skenarë të tjerë). Punë janë të gjitha godinat e bashkisë. (Nuk isha në njësi po isha në qendër. Pse nuk shikon kamerat? Pra isha në punë se më vinin Policat Bashkiak. Më bërtiste Dr. Burimeve Njerëzore që të dilja nga zyra. Më ka parë gjatë gjithë ditës Drejtori i Financës (i cili thotë që më bënë presion Kryetari për të firmosur shkresat). Unë jam larg Drejtorisë dhe Drejtorive që më lidh puna. Më pengon në realizimin e detyrave të mia. Veçimi është formë e rëndë e diskriminimit. Kjo është abstrakte.

7. Në lidhje me rishikimin e masës disiplinore.

Kryetari nuk do. Sepse e ka bërë të qëllimshme. Ajo është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë: 1. Të ribënte edhe njëherë komisionin (është e drejta ime të kërkoja komision tjetër); 2. Të anulonte urdhrin. Kjo nuk i interesonte se do komandonte drejtorë tatimesh punonjësin që donte vetë ai.

8. Në lidhje me incidentin

Më nxori nga mbledhja duke urdhëruar Policinë Bashkiake, vetëm se thashë “Mos na bëni presion”. Nuk u prish mbledhja, por ju prish mendja e Sekretarit, që vuri gjithçka për ta mbuluar dhe zbuluar nga frika denoncimit që i bëra. Unë u nxora me forcë, se thashë nuk largohem. Por, polici A.S, miku i Kryetarit të Bashkisë A.S, më kërcënoi se ne do të nxjerim nga zyra. Materialet e zyrës u nxorën mbas orarit punës, duke shqyer derën të cilën unë e kisha mbyllur (unë kam qënë vetëm në zyrë nuk kam pasur punonjës të tjerë, ku gënjehet që ishte penguar puna). Materialet i levizën vetë, unë nuk zura materiale me dorë. Në mëngjes unë u gjeta në zyrë tjetër, me materiale të “shkrafanjitura” (disa materiale dosje pune mi kishte lënë në zyrën ku isha). Punonjësi që zuri zyrën, nuk vinte me javë në punë. Për të punuar me dosjet, ai më la çelësin e zyrës. Pra, nuk ishte emegjente shqyerja e derës dhe veprimet e sekretarit dhe policisë, që i urdhëron si do ai. Pas denoncimit Sekretari u bë më keq. Ai vazhdon të bëjë keq, sa herë i jepet mundësia. Shembull: Jam në zyrë te ai në qendër për punë, më telefonon, dërgon punonjës në njësi për mungesat. Çfarë mund të quhet, veç monstër. Veprime që një normal nuk i bënë dot.

3. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁵, të ndryshuar, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 21.12.2022. Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak të pamundësisë së subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa për të marrë pjesë. Për të siguruar prezencën e palëve në seancë dëgjimore dhe për të garantuar të drejtën e palëve për t’u dëgjuar, Komisioneri shtyu zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 18.01.2023.

Seanca dëgjimore e datës 18.01.2023, u zhvillua me pjesëmarrjen e ankueses, e cila ishte personalisht prezent, dhe dy prej subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa, z. F.D, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Cërrik dhe znj. M.Xh , Drejtore e Burimeve Njerëzore, Bashkia Cërrik. Në seancë nuk mori pjesë z. A.S , Kryetar i Bashkisë Cërrik.

Gjatë seancës dëgjimore, palët mbajtën të njëjtin qëndrim që kishin përcjellë pranë Komisionerit nëpërmjet komunikimit shkresor. Z. F.D, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Cërrik, pretendoi se nga ana e ankueses është përdorur gjuhë urrejtje kundrejt personit të tij. Ai gjithashtu parashtroi se problematika e paraqitur nga ankuesja ishte trajtuar edhe nga institucioni i Avokatit të Popullit, i cili nuk kishte konstatuar shkelje nga ana e Bashkisë Cërrik.

4. Në vijim të seancës dëgjimore, me e-mail datë 30.01.2023, znj. M.Xh , Drejtore e Burimeve Njerëzore, Bashkia Cërrik, ka përcjellë dokumentacionin shtesë: procesverbal datë 17.06.2021, procesverbal datë 29.06.2021, procesverbal datë 10.06.2021, procesverbal datë 05.07.2021, vendim nr. 07, datë 01.08.2021, i Njësisë Përgjegjëse, Bashkia Cërrik, Urdhër i Brendshëm i Kryetarit të Bashkisë Cërrik nr. 144, datë 01.08.2021 “Për pezullimin në shërbimin civil”, Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Cërrik Nr.113, datë 23.06.2021 “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”, Njoftim i Komisionit Disiplinor, Bashkia Cërrik Nr. 2079 prot., datë 24.06.2021 “Për nisjen e procedurës disiplinore për punonjësit” (që i përket punonjës F.F)
5. Me e-mail datë 20.02.2023, ankuesja ka depozituar parashtrimet e saj në lidhje me dokumentacionin e sipërcituar, duke pretenduar se procesverbalet e dërguara nga Bashkia Cërrik janë fiktive, ndërsa në lidhje me punonjësen F. F., deklaroi se kjo punonjëse është larguar vetë.
6. Me shkresën nr. 320 prot., datë 27.02.2023, Komisioneri i është drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, duke kërkuar informacion në lidhje me trajtimin e rastit të znj. M.Ll dhe konkluzionet e arritura në përfundim të hetimit administrativ të kryer prej këtij institucioni në lidhje me rastin e ankueses. Me shkresën nr.128/1 prot., datë 02.03.2023, Avokati i Popullit, ka vendosur në dispozicion shkresën nr. K 3/M13-5 prot., datë 14.10.2022, nëpërmjet të cilës i

⁵ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

është kthyer përgjigje ankueses, në të cilën gjendet hetimi administrativ i përfunduar nga institucioni i Avokatit të Popullit.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja M.Llështë e datëlindjes 08.12.1966. Ajo ka përfunduar studimet e larta në vitin 1990 pranë Fakultetit të Ekonomisë, në Universitetin e Tiranës, në degën e “Merceologjisë”. Në vitin 2012, ankuesja ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Ekonomisë, pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan duke u pajisur me Diplomë Bachelor në “Financë – Kontabilitet” dhe në vitin 2013 ka përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë në Fakultetin e Ekonomisë pranë Universitetit “Kristal”, duke u pajisur me Diplomë Master i Shkencave në Financë.

Referuar librezës së punës, ankuesja ka filluar punë pranë Bashkisë Çërrik në vitin 1997 dhe ka punuar në pozicione të ndryshme pune pranë këtij institucioni. Nëpërmjet aktit të emërimit nr. 2749 prot., datë 01.11.2016, ankuesja është emëruar nëpunëse civile, në pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit të Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Shtetërore, me kategori page III-A, pozicion të cilin mban edhe aktualisht.

Gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi se, me urdhrin nr. 92, datë 08.06.2021, të Kryetarit të Bashkisë Çërrik, është urdhëruar sistemimi i zyrave për punonjësit e godinës së Bashkisë Çërrik. Sipas këtij urdhëri me zbatimin e të cilit ngarkohej Policia Bashkiake, midis të tjerave urdhërohej që lëvizja e punonjësve në zyrat ku ata ishin caktuar, duhet të përfundonte brenda datës 09.06.2021, ora 11:00 dhe pa krijuar problem në shërbimet e ofruara ndaj banorëve. Ky urdhër sillte ndryshime edhe për ankuesen, e cila duhet të transferohej nga kati i dytë për në katin e parë të godinës së bashkisë. Të nesërmen e daljes së këtij urdhri, në datën 09.06.2021, në ambientet e Bashkisë Çërrik, është zhvilluar një mbledhje me punonjësit e kësaj bashkie e drejtuar nga z. F.D, Sekretar i Përgjithshëm, ku ka qenë prezent edhe ankuesja. Gjatë mbledhjes ka patur një debat midis ankueses dhe Sekretarit të Përgjithshëm.

Në datën 10.06.2021, ankuesja ka bërë kallëzim për përdorim të dhunës psikologjike dhe fizike gjatë mbledhjes së zhvilluar në datën 09.06.2021, pasi me urdhër të z. Doka ishte nxjerrë me dhunë nga mbledhja nga ana e policisë bashkiake. Me vendimin e datës 30.06.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Elbasan ka vendosur mosfillimin e procedimit penal të paraqitur nga ankuesja, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në këtë vendim, ndër të tjera konstatohet: *“Në analizë të provave të administruara argumentojmë se nuk jemi para elementëve të ndonjë veprë tjetër penale të parashikuar nga Kodi Penal, pasi në rastin konkret bëhet fjalë për një debat me fjalë, që kanë patur në mbledhje punonjësit e Bashkisë Çërrik dhe në këto kushte nuk jemi para*

elementëve të ndonjë veprë penale”. Ky vendim i është komunikuar ankueses me shkresën nr. 380 prot., datë 08.07.2021. Gjatë shqyrtimit nuk rezultoi që ky vendim të jetë kundërshtuar nga ankuesja.

Në datë 23.06.2021, Bashkia Cërrrik ka bërë kallëzim penal kundër ankueses për veprat penale të *“Shkatërrimit të pronës”* dhe *“Prishje e qetësisë publike”*, parashikuar nga nenet 150 dhe 274 të K.Penal, me pretendimin se në datën 11.6.2021 ankuesja ka dëmtuar karrigen e zyrës dhe me sjelljen e saj ka prishur qetësinë publike. Me vendimin e datës 28.10.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë hetimeve paraprake ka vendosur se çështja penale duhet të pushohet sepse fakti nuk përbën veprë penale dhe nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Në këtë vendim, ndër të tjera konstatohet: *“...nga hetimi në tërësi i faktit ka rezultuar se: Më datë 8.6.2021, Kryetari i Bashkisë Cërrrik në kuadrin e ristrukturimit dhe miratimit të strukturës së re të Bashkisë Cërrrik, për t'i shërbyer sa më mirë qytetarëve, ka nxjerrë urdhrin nr. 92, datë 08.06.2021. Sipas këtij urdhri me zbatimin e të cilit ngarkohej Policia Bashkiake midis të tjerave udhërohej që brenda datës 09.06.2021, ora 11:00, të kishte përfunduar lëvizja e punonjësve në zyrat që u kishin caktuar, pa krijuar problematikë në shërbimin e qytetarëve. Të gjithë punonjësit e bashkisë e kanë zbatuar urdhrin përveç punonjësës shtetases M.Lle cila punon në Sektorin e Pronave e që në vijim do të kryente shërbimin në një zyrë të ndodhur në katin e parë, ndërsa zyrën ku ajo kishte kryer shërbimin në katin e dytë ishin caktuar të vinin të tjerë punonjës të një sektori tjetër. Kjo punonjësë ka refuzuar ta zbatojë urdhrin e mësipërm dhe më datë 10.06.2021 ka mbyllur derën me çelës duke u larguar nga zyra pa e dorëzuar çelësin e zyrës. Në datën 11.6.2021 ajo ka debatuar me punonjësit e policisë bashkiake shtetaset S.K, T.Sh, A.M dhe I.M, me tone të larta duke u bërë pengesë për të dorëzuar zyrën për punonjësit e tjerë. Sipas deklarimeve të punonjësve të Policisë Bashkiake shtetësja M.Ll, më datë 11.06.2021, në gjendje të acaruar ka dëmtuar karrigen e zyrës. ...Organi procedues vlerëson se në rastin konkret nuk plotësohet elementi i anës objektive të figurës së veprës penale pasi në rastin konkret dëmtimi i pronës është kryer me dashje, por pasoja materiale, prej 500 lekë, është e një natyre jo të rëndë...Gjithashtu prokurori vlerëson se, në faktin e hetuar mungojnë edhe elementët e figurës së veprës penale të “Prishja e qetësisë publike” parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal... Shtetësja e kallëzuar M.Llka qenë në kushtet e mosveprimit dhe të mosbindjes për të zbatuar një urdhër të brendshëm të titullarit dhe nuk ka kryer veprime që vijnë në kundërshtim me parashikimet e kësaj dispozite....”*

Me urdhrin nr. 117, datë 29.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Cërrrik *“Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”*, është ngritur Komisioni Disiplinor (KD) në Bashkinë Cërrrik për të shqyrtuar shkeljen e pretenduar ndaj ankueses *“Braktisje të vendit të punës pa justifikim gjatë orarit zyrtar”*. Në përbërjen e KD mungon pjesmarrja e nëpunësit më të lartë civil, që është Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Cërrrik. Shkeljet e pretenduara janë pasqyruar në procesverbalin e datës 10.06.2021, procesverbalin e datës 17.06.2021 dhe procesverbalin e datës 29.06.2021, të tre këto procesverbale, janë mbajtur nga një komision i përbërë nga tre punonjës. Referuar procesverbaleve, rezulton se në të tre datat e sipërcituara ankuesja ka munguar gjatë gjithë ditës.

Ankuesja është njoftuar për fillimin e procedurës disiplinore nëpërmjet shkresës nr. 2129 prot., datë 29.06.2021, duke caktuar si datë për shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara datën 06.07.2021, ora 12:00. Rezulton se ankuesja ka qenë prezent në seancën dëgjimore para KD, duke parashtruar pretendimet e saj, duke pretenduar se, për ditët kur pretendohet se ajo ka braktisur vendin e punës ka patur justifikim, ka qenë duke përmbushur detyrat e saj funksionale në terren në zbatim të urdhrin të kryetarit të bashkisë.

Sipas procesverbalit që mban datën 05.07.2021, punonjësit T.Z, A.D, SH.L, Z.I, kanë deklaruar se, në datat në të cilat pretendohet shkelja disiplinore, nuk ka qenë në zbatim të urdhrin të Kryetarit të Bashkisë, asnjë anëtar i komisionit.

Në përfundim, KD, me vendimin nr. 06, datë 06.07.2021 (nr. 2220 prot., datë 06.07.2021), është shprehur se, shkelja e pretenduar ishte e bazuar, por duke vlerësuar se kemi të bëjmë me shkelje të lehtë të disiplinës, mbështetur në pikën 1/c, të nenit 57, në germën “a”, të nenit 58, dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, çështja i është dërguar për kompetencë eprorit direkt.

Me urdhrin nr. 06/1, datë 06.07.2021 “Për dhënien e masës disiplinore”, eprori direkt i ankueses, duke u bazuar në vendimin nr. 06, datë 06.07.2021, të KD, ka vendosur që ndaj ankueses të jepet masë disiplinore “Vërejtje”. Konstatohet se, eprori direkt, i cili ka dhënë masën disiplinore ka qenë pjesë e KD. Masa disiplinore është konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë dhe i është komunikuar ankueses me shkresën e datës 07.07.2021.

Pas marrjes dijeni për masën disiplinore, ankuesja në datë 09.07.2021 ka paraqitur dy ankesa, një nëpërmjet shkresës me lëndë “Ankesë për vendimin nr. 2220, dt.06.07.2021” (për thyerjen e disiplinës në punë për sa i përket orarit të punës) drejtuar Kryetarit të Bashkisë, KD dhe Burimeve Njerëzore dhe shkresën me lëndë “Ankesë, kundërshtim për vendimin nr.2235, dt.07.07.2021 Për thyerje mase disiplinore “Vërejtje”, drejtuar Kryetarit të Bashkisë, nëpërmjet të cilave ka ngritur pretendimin se masa disiplinore është e paligjshme e pabazuar dhe se, ndaj saj janë marrë dy masa disiplinore për të njëjtën shkelje

Në lidhje me masën disiplinore, në datën 09.08.2021, ankuesja ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), në të cilën ka ngritur pretendime për parregullsi gjatë procedurës disiplinore të zhvilluar ndaj saj, që ka përfunduar me dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”. Me vendimin nr. 133, datë 28.10.2021, në përfundim të hetimit administrativ të zhvilluar për verifikimin e ligjshmërisë së procedurës disiplinore përfunduar me masëm ‘Vërejtje’ ndaj ankueses, KMSHC ka arritur në konkluzionin se: “si nga pikëpamja procedurale ashtu dhe nga ajo materiale, janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit, duke filluar nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vënies në dijeni për këtë fakt, të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, dëgjimin e thënieve të saj dhe administrimin e provave materiale të nevojshme, deri në marrjen e aktit nga eprori direkt dhe konfirmimit të tij nga Kryetari i Bashkisë Çërrik.”.

Ankuesja nuk e ka kundërshtuar masën disiplinore “vërejtje” në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Nga provat e administruara, rezulton e provuar se, ankuesja ka aplikuar në procedurën “ngritje në detyrë” në shpalljen e publikuar nga Bashkia Cërrik në datën 02.09.2021, në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore.” Ankuesja nuk është kualifikuar për të vijuar konkurimin për këtë pozicion pune me arsyetimin se, kishte masë disiplinore në fuqi. Ankuesja ka marrë dijëni për arsyen e moskualifikimit në datën 05.10.2021.

Në datën 22.12.2021, ankuesja ka paraqitur një ankesë drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, kundër vartëses së saj, punonjësës S.O, në të cilën ka pretenduar se kjo punonjëse ka ushtruar dhunë psikologjike dhe fizike në vendin e punës. Sipas ankueses, kjo punonjëse kishte ushtruar dhunë edhe ndaj punonjësve të tjerë. Ankuesja ka kërkuar zbatimin e Kodit të Punës dhe largimin e kësaj punonjëse nga puna. Në po të njëjtën datë, 22.12.2021, ka paraqitur një kërkesë drejtuar Kryetarit të Bashkisë Cërrik, punonjësja S.O, duke pretenduar se, është nën trysni dhe bullizëm të vazhdueshëm nga ana e përgjegjësës së saj dhe rasti më i fundit kishte ndodhur në datën 22.12.2021. Në këtë kërkesë, punonjësja S.O ka kërkuar që të transferohej në një vend tjetër pune pasi në këto kushte nuk mund të vazhdonte punën.

Bashkia Cërrik, informoi gjatë shqyrtimit të ankesës se, nga ana e Kryetarit të Bashkisë, i është kërkuar informacion Policisë Bashkiake, e cila ka zyrën pranë zyrës ku punon ankuesja, nëse ishin konstatuar elementë të dhunës dhe nëse ka patur kërkesë për ndihmë apo debate me tone të larta. Nga ana e Policisë Bashkiake është referuar se nuk ka patur asnjë rast ankese prej asnjë prej palëve apo kërkesë të çfarëdolloji dhe pse kanë qenë shumë afër dhe policët e shërbimit kanë qenë në dispozicion në katin e parë të objektit. Në vijim, Kryetari i Bashkisë Cërrik ka pranuar kërkesën e punonjësës S.O. duke e transferuar në detyrën e specialistes së terrenit për vjeljen e të ardhurave NJA Klos, ku vazhdon të punojë sipas urdhrin nr.11, datë 12.01.2022.

Me urdhrin nr. 130, datë 15.04.2022, “Për ndryshimin e orarit të punës së administratës dhe ndryshimin e nenit 31, të Regullores së Brendshme organizative të Bashkisë Cërrik”, të Kryetarit të Bashkisë është vendosur që, orari i punës deri në datën 22.09.2022, në Bashki qendër do të jetë, nga e hëna në të premte 09:00-13:00; 13:00-14:00 pushim; 14:00-18:00 dhe në Njësitë Administrative nga e hëna në të premte 07:00-15:30. Ankuesja deklaroi se në lidhje me ndryshimin e orarit të punës, të cilin e ka konsideruar të pabazuar ka bërë ankesë pranë KMSHC.

Me shkresën nr.447/3 prot., datë 07.07.2022, me lëndë “Mbi vlerësimin e ligjshmërisë së Kryetarit të Bashkisë Cërrik nr.130, datë 15.04.2022, “Për ndryshimin e orarit të punës së administratës dhe ndryshimin e nenit 31 të rregullores së brendshme organizative të Bashkisë Cërrik”, KMSHC, ka vlerësuar se akti nr. 130, datë 15.04.2022, me të cilin është ndryshuar orari i punës është nxjerrë në përputhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe me vendimin nr. 568, datë 06.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre

në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore". Në këtë shkresë, nuk jepen të dhëna në lidhje me subjektin/subjektet të cilët kanë vënë në lëvizje institucionin e KMSHC.

Rezulton se me urdhrin nr. 229, datë 02.06.2022 të Kryetarit të Bashkisë "*Për ndryshimin e zyrave*" është urdhëruar së Sektori i Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Publike, në të cilin punojnë ankuesja M.Ll , Përgjegjëse Sektori, S.Sh., Specialist Sektori dhe A.B., Specialiste Sektori, të zhvendoset me zyrë në ambientet e *One Stop Shop*, ndërsa punonjësit e Sektorit Social, ku punojnë I.A., Përgjegjës Sektori dhe A.P., Specialist Sektori, të zhvendosen me zyrë në ambientet e godinës qendrore të Bashkisë Cërrrik.

Në datën 06.06.2022, ankuesja ka bërë një ankesë për rishikimin e urdhrin të mësipërm të kryetarit të bashkisë për ndryshimin e zyrave, drejtuar Kryetarit të Bashkisë, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, duke pretenduar se ndryshimi ka ndodhur si hakmarrje e Sekretarit të Përgjithshëm dhe nuk është i diktuar nga nevoja. Ankuesja ka refuzuar të zhvendoset në zyrën e re të përcaktuar sipas urdhrin nr. 229, datë 02.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë, me pretendimin se është në pritje të ankesës drejtuar Kryetarit të Bashkisë për paligjshmërinë e urdhrin.

Me shkresën nr.1897 prot., datë 13.06.2022 me lëndë "*Kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore për nëpunësen z. M.Ll* ", Drejtori Financës e Pronave Publike, në Bashkinë Cërrrik, i është drejtuar KD, pranë kësaj bashkie, duke kërkuar në cilësinë e eprorit direkt të ankueses, fillimin e procedurës disiplinore ndaj saj, për mungesë të pajustificuar për tre ditë në vendin e punës, konkretisht në datat 6, 7 dhe 8 qershor 2022 dhe moszbatim të urdhrin të titullarit, urdhrin nr. 229, datë 02.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë. Me urdhrin nr. 357, datë 08.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë dhe bazuar në kërkesën e eprorit direkt të ankueses për fillimin e procedurës disiplinore, është ngritur KD në Bashkinë Cërrrik, për të shqyrtuar shkeljen e pretenduar ndaj ankueses "*Braktisje të vendit të punës pa justifikim gjatë orarit zyrtar*". Konstatohet se Sekretari i Përgjithshëm nuk është anëtar i KD. Me shkresën nr. 2572 prot., datë 08.09.2022, të KD, ankuesja është njoftuar për fillimin e procedurës disiplinore ndaj saj duke caktuar si datë për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore të pretenduara datën 20.09.2022.

Nga aktet e administruara nuk janë kryer veprime të tjera në lidhje me procedurën e mësipërme disiplinore. Gjatë seancës dëgjimore, z. F.D, deklaroi se procedura disiplinore ndaj ankueses nuk kishte vijuar për shkak të ankesave që ankuesja kishte paraqitur pranë institucioneve dhe në këto kushte Bashkia Cërrrik kishte vlerësuar që të mosvijonte më tej, deri sa këto institucione të shpreheshin në lidhje me pretendimet e ankueses.

Nga aktet e administruara rezulton se, ankuesja në lidhje me të njëjtat pretendime të ngritura pranë Komisionerit, i është drejtuar edhe institucionit të Avokatit të Popullit. Me shkresën nr. K3/M13-5 prot., datë 14.10.2022 me lëndë "*Kthim përgjigje*", institucioni i Avokatit të Popullit i ka kthyer përgjigje ankueses. Referuar kësaj shkrese, Avokati i Popullit në përfundim të procedurës së

shqyrtimit të ankesës së paraqitur prej ankueses, nuk rezulton të ketë konstatuar veprime ose mosveprime të paligjshme ose të parregullta nga ana e Bashkisë Cërrik.

Ankuesja ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr. 142 regj, datë 16.09.2022, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të moshës dhe gjendjes arsimore, nga z. A.S , Kryetar i Bashkisë Cërrik, z. F.D, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Cërrik dhe znj. M.Xh , Drejtore e Burimeve Njerëzore, Bashkia Cërrik.

Bazuar në faktet, parashtrimet dhe kërkimet e palëve, si dhe provave të administruara gjatë procedurës administrative të zhvilluar për shqyrtimin e ankesës, Komisioneri ka arritur në përfundimet e mëposhtme:

- Në lidhje me masën disiplinore “Vërejtje” të dhënë ndaj ankueses në datën 06.07.2021.

Ankuesja M.Llështë nëpunëse civile dhe marrëdhëniet e saj të punës rregullohen në bazë të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Disiplina në shërbimin civil gjen rregullim në kapitullin X, nenet 57-61 të ligjit nr.152/2013, të ndryshuar. Dispozitat që gjejnë zbatim në çështjen në shqyrtim, paraqiten si më poshtë:

Neni 57

Përgjegjësia për masat disiplinore

1. Nëpunësi civil është përgjegjës për shkeljen me faj të detyrimeve të nëpunësit civil sipas ligjit. Shkeljet në shërbimin civil ndahen në:

- a) shkelje shumë të rënda;
- b) shkelje të rënda;
- c) shkelje të lehta.

.....

4. Janë shkelje të lehta:

- a) mungesa e pajustificuar në punë deri në 3 ditë pune;
- b) shkelja e rregullave të etikës;
- c) sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun;
- ç) kryerja, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cënojnë figurën e nëpunësit civil, institucionin apo shërbimin civil në tërësi.

Neni 58

Llojet e masave disiplinore

Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë:

- a) vërejtje;
- b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj;
- c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet;
- ç) largim nga shërbimi civil.

Neni 59

Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore

1. Masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “a” të nenit 58 të këtij ligji, merret nga eprori direkt. Eprori direkt detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen me faj të detyrimeve nga nëpunësi civil.

2. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 58 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor.

.....

4. Komisioni disiplinor fillon procedimin:

a) me kërkesë të eprorit direkt të nëpunësit civil;

b) me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo audit, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil;

c) me nismën e çdo anëtari të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore.

.....

7. Procedimi administrativ disiplinor garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Nëpunësi civil mund të asistohet gjatë procedimit disiplinor nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, një avokat apo një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate.

8. Procedimi disiplinor fillon pa vonesë, me marrjen dijani për një shkelje disiplinore, por jo më vonë se brenda një afati 2-vjeçar nga data e kryerjes së shkeljes. Në rastin e shkeljeve të rënda, që mund të rezultojnë në marrjen e masës disiplinore të largimit nga shërbimi civil, afati është 8 vjet.

Bazuar në faktet që rezultuan të provuara gjatë shqyrtimit të ankesës dhe provat e administruara rezultojnë se, procedimi administrativ disiplinor i zhvilluar ndaj ankueses i cili është përfunduar me dhënien e masës disiplinore “vërejtje”, ka garantuar të drejtën e ankueses si nëpunëse civile, për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen e pretenduar, të drejtën për t’u dëgjuar dhe për të paraqitur prova.

Procedimi disiplinor ka filluar me kërkesën e Njesisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, e cila bazuar në nenin 59, pika 4, të ligjit nr.152/2013, të ndryshuar, legjitimohet si subjekt që mund të vërë në lëvizje KD. Referuar nenit 58, të ligjit nr.152/2013, të ndryshuar, masa disiplinore “vërejtje”, parashikohet si një nga masat që mund të merret ndaj një nëpunësi civil. Konform nenit 57, pika 4 germa “a”, të po këtij ligji, shkelja është klasifikuar drejtë si shkelje e lehtë, pasi kemi të bëjmë me mungesë të pajustificuar në punë deri në 3 ditë pune. Masa disiplinore “vërejtje”, është marrë nga eprori direkt, në përputhje me nenin 59, pika 1, të ligjit nr.152/2013, të ndryshuar.

Rezultoi e provuar se, shkeljet e pretenduara janë materializuar në procesverbalet përkatëse dhe se ankuesja nuk arriti të provojë pretendimet e saj se nuk kishte munguar pa arsye në punë. Punonjësit me të cilin ankuesja pretendon se ka punuar në zbatim të urdhrin nr. 1784/1, datë 04.06.2021, të Kryetarit të Bashkisë, sikurse është z. Z.I, ka hedhur poshtë pretendimin e ankueses nëpërmjet deklarimeve të shprehura në procesverbalin e datës 05.07.2021. Z. T.Z, Nënkyetar i Bashkisë Cërrrik dhe z .H. K., eprori i ankueses, të cilët kanë qenë anëtarë të Komisionit Disiplinor, nuk kanë konfirmuar pretendimin e ankueses se ajo nuk është paraqitur në punë me dijeninë dhe lejen e tyre, apo që ankuesja ka punuar në terren në zbatim të urdhrin nr.1784/1, datë 04.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë dhe se për këtë fakt ka vënë në dijeni eprorin e saj direkt. Në kuadër të hetimit të zhvilluar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan lidhur me kallëzimin penal të paraqitur nga Bashkia Cërrrik ndaj ankueses, ka rezultuar e provuar se, në datën 10.06.2021, ankuesja ka mbyllur derën me çelës dhe është larguar nga zyra pa dorëzuar çelësin. (*referuar vendimit të datës 28.10.2021 për pushimin e çështjes penale, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan*). Fakti që ankuesja nuk ka qenë në punë në datën 10.06.2021, rezultoi i provuar edhe nga vendimi për mosfillimin e procedimit penal të datës 30.06.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku pasqyrohet se, më datë 10.06.2021 ora 10:00, ankuesja është paraqitur në Komisaratin e Policisë Cërrrik për të paraqitur kallëzimin e saj.

Komisioneri merr në konsideratë edhe vendimarrjen e KMSHC, si një institucion i specializuar në kuadër të zbatimit të legjislationit për nëpunësin civil, i cili me vendimin nr.133, datë 28.10.2021, ka arritur në përfundimin se, procedura disiplinore e përfunduar me masën “vërejtje” ndaj nëpunëses M.Ll , është e bazuar në ligj, si nga pikëpamja procedurale ashtu edhe nga ajo materiale, si dhe faktin që, në përfundim të hetimit të zhvilluar nga Avokati i Popullit për të njëjtat pretendime të paraqitura nga ankuesja edhe pranë Komisionerit, ky institucion nuk ka konstatuar veprime ose mosveprime të paligjshme dhe të padrejta ndaj ankueses.

Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja nuk i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë gjatë procedurës disiplinore të përfunduar me masën “vërejtje” ndaj ankueses M.Ll .

- **Në lidhje me pretendimin e ankueses për moskualifikimin në procedurën “ngritje në detyrë” për pozicionin e shpallur “Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore”.**

Motivacioni për moskualifikimin e ankueses për të vazhduar konkurimin për pozicionin e shpallur “Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore” është fakti se, ankuesja kishte masë disiplinore në fuqi.

Sa më sipër, rezultoi e provuar se, me vendimin nr. 6, datë 6.7.2021, të eprorit direkt, ndaj ankueses është marrë masa disiplinore “vërejtje” dhe se kjo masë disiplinore nuk është kundërshtuar nga ankuesja në gjykatë.

Në nenin 61 “*Shuarja e masave disiplinore*”, pika 1, germa “a”, të ligjit nr.152/2013, të ndryshuar, parashikohet: “1. Masat disiplinore shuhen, për shkak të ligjit, pas kalimit të këtyre afateve: a) 2 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën “a” të nenit 58 të këtij ligji;”

Në kushtet kur, masa disiplinore ndaj ankueses është marrë në datën 06.07.2021, nuk është kundërshtuar në gjykatë, dhe në referim të dispozitës së mësipërme ligjore, kjo masë disiplinore nuk është shuar sipas ligjit, përligj pretendimin e Bashkisë Cërrrik se, ankuesja në momentin e procedurës së rekrutimit ka patur masë disiplinore në fuqi.

Në pikat 1 e 2, të Kreut III, të VKM Nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, të ndryshuar, parashikohet se : “1. Në rastet kur një vend vakant në kategorinë e nivelit të ulët apo të mesëm drejtues nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse shpall procedurën e ngritjes në detyrë. 2. Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë: a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar; b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi; c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”; ç) të plotësojë kushtet e tjera të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil; d) Të përmbushë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim”.

Rezulton se, në bazë të germës “b” të pikës 2, të Kreut III, të VKM-së nr. 242, datë 18.3.2015, të ndryshuar, në procedurën e ngritjes në detyrë, është një kërkesë ligjore e detyrueshme fakti që nëpunësi civil të mos ketë masë disiplinore në fuqi. Sa më sipër rezultoi e provuar se ankuesja në momentin e aplikimit në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore”, ka patur masë disiplinore në fuqi, fakt ky që vjen në kundërshtim me kërkesën e mësipërm ligjore.

Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja M.Ll , nuk i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë, si pasojë e moskualifikimit të saj në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore”.

- Në lidhje me pretendimin për përdorim të dhunës në vendin e punës.

Ankuesja ka pretenduar se ka qenë viktimë e dhunës psikologjike dhe fizike në vendin e punës. Në lidhje me këtë, ankuesja ka pretenduar se ndaj saj është ushtruar dhunë në mbledhjen e zhvilluar në datë 9.6.2021, në datën 22.12.2021 nga vartësja e saj punonjësjë S.O, si dhe gjatë ndryshimit të zyrës në qershor 2022.

Në lidhje me pretendimin për përdorim të dhunës gjatë mbledhjes së zhvilluar në datën 9.6.2021, Komisioneri konstaton se, këto pretendime ankuesja i ka parashtruar edhe përpara organit të prokurorisë, i cili me vendimin e datës 30.6.2021, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se, *në rastin konkret bëhet fjalë për një debat me fjalë, që kanë patur në mbledhje punonjësit e Bashkisë Cërrrik dhe nuk konstatohen elementë të ndonjë veprë penale.* Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk u administruan akte dhe prova, për të vërtetuar dhe provuar natyrën dhe ashpërsinë e debatit, për të vlerësuar nëse kemi të bëjmë me elementë të diskriminimit, të

shfaqur në formën e shqetësimit, parashikuar nga neni 3, pika 13, të LMD, ku sanksionohet: *“13. “Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.”*

Në lidhje me pretendimin e ankueses se ndaj saj, në datën 22.12.2021, është ushtruar dhunë psikologjike dhe fizike, nga ana e vartëses së saj, punonjësës S.O, rezultoi se, ankuesja ka depozituar një ankesë me shkrim pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Bashkinë Cërrrik, duke kërkuar largimin nga puna të punonjësës S.O. Po në të njëjtën ditë, datë 22.12.2021, pretendime për sjellje të papërshtatshme, sjellje tallëse dhe bullizuese, janë ngritur njëkohësisht edhe nga punonjësja S.O kundër ankueses, për të cilat ankuesja deklaroi se nuk ka patur dajeni.

Sipas informacionit të dhënë nga Bashkia Cërrrik, rezulton se, në bazë të verifikimeve të kryera nga ana e saj, në kuadër të pretendimeve të paraqitura nga ankuesja dhe punonjësja S.O karshi njëra tjetrës, nuk kishte arritur të konkludonte në lidhje me bazueshmërinë e tyre. Gjithashtu, edhe gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk u administrua asnjë akt apo provë, për të vërtetuar pretendimin për ushtrim të dhunës psikologjike apo fizike ndaj ankueses nga ana e punonjësës S.O, sikurse edhe pretendimet e kësaj të fundit ndaj ankueses.

Komisioneri vlerëson se, veprimi i Bashkisë Cërrrik, për të transferuar punonjësën S.O, në një pozicion tjetër pune, mbi bazën edhe të kërkesës së paraqitur nga kjo punonjëse, mund të vlerësohet si një qasje efektive, në kushtet e ankesave reciproke të ngritura nga këto punonjëse kundrejt njëra tjetrës dhe faktit që asnjë nga këto ankesa nuk u arrit që të provohej.

Në lidhje me pretendimin për ushtrim të dhunës gjatë transferimit të zyrave në muajin qershor 2022, nuk u administrua asnjë fakt ose provë, që vërteton këtë pretendim të ankueses.

Sa më sipër, pretendimet e ankueses për përdorim të dhunës psikologjike dhe fizike nuk rezultuan të provuara, ndërsa ankuesja M.Ll , nuk rezultoi që t'i jetë nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë, gjatë trajtimit të pretendimeve për përdorim të dhunës nga punonjësja S.O.

- Në lidhje me pretendimet e ankueses për ndryshimin e zyrës.

Bazuar në faktet dhe provat e administruar gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se, ndryshimi i zyrës së ankueses si në qershor 2021, ashtu edhe në qershor 2022, ka ndodhur bazuar në një urdhër të shkruar të punëdhënësit Bashkia Cërrrik. Ndryshimi i zyrave në të dy rastet, nuk ka ndodhur vetëm për ankuesën, por edhe për punonjës të tjerë. Konkretisht me urdhrin nr. 92, datë 08.06.2021 të kryetarit të Bashkisë Cërrrik është urdhëruar sistemimi në zyra për të gjithë punonjësit e bashkië, ndërsa me urdhrin nr. 229, datë 02.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë Cërrrik, është urdhëruar

ndryshimi i zyrave për Sektorin e Inventarizimit dhe Regjistrimit të Pronave Publike, ku bën pjesë jo vetëm ankuesja por edhe 2 punonjës të tjerë dhe punonjësit e Sektorit Social, ku janë 2 punonjës. Ndryshimi i zyrës së ankueses, për të dy rastet, nuk rezulton që të ketë ndodhur në distanca të largëta. Në rastin e parë, në qershor 2021 ankuesja është zhvendosur me zyrë nga kati i dytë për në katin e parë, të të njëjtës godinë, ndërsa në rastin e dytë, në qershor 2022, ankuesja është zhvendosur me zyrë në një godinë tjetër, ku Bashkia Cërrik ushtron funksionet e saj ligjore, e cila sipas Bashkisë është në një distancë jo më të madhe se 150 m, nga godina qendrore e Bashkisë Cërrik, ku ankuesja ka patur zyrën.

Komisioneri vlerëson se, Bashkia Cërrik në cilësinë e punëdhënësit ka të drejtën dhe diskrecionin, që të përcaktojë sistemimin e punonjësve në vendet e punës ku ata duhet të ushtrojë detyrat e tyre funksionale, në mënyrën që ajo vlerëson më të përshtatshme.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankuesja M.Llnuk i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të disfavourshëm dhe të pabarabartë, në lidhje me ndryshimin e zyrës.

- **Në lidhje me procedimin disiplinor të filluar me kërkesën e datës 13.06.2022 të eprorit direkt, për të shqyrtuar shkeljen e pretenduar ndaj ankueses “Braktisje të vendit të punës pa justifikim gjatë orarit zyrtar” lidhur me mungesë të pajustificuar për tre ditë në vendin e punës, konkretisht në datat 6, 7 dhe 8 qershor 2022 dhe moszbatim të urdhrin të titullarit, urdhrin nr. 229, datë 02.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë.**

Referuar fakteve të provuara gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se, në lidhje me kërkesën e paraqitur nga ana e eprorit direkt të ankueses, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Komisioni Disiplinor pranë kësaj bashkie, për të shqyrtuar shkeljen e pretenduar ndaj ankueses dhe është realizuar njoftimi i ankueses në lidhje me fillimin e procedurës disiplinore ndaj saj.

Meqënëse në lidhje me këtë procedim disiplinor KD nuk ka proceduar me veprime të mëtejshme dhe nuk ka një vendimarrje, e cila të ketë çenuar interesat e ankueses deri në këto momente, Komisioneri nuk mund të shprehet në lidhje me këtë moment.

Në lidhje me pretendimet e ankueses, për përdorimin e termave të papërshtatshëm në lidhje e moshën, duke ju referuar me termin “plaka”, Komisioneri vlerëson se, ndodhemi në kushtet kur pretendimi i ankueses është thjesht i karakterit deklarativ dhe nuk rezulton i provuar në ndonjë provë, akt apo rrethanë tjetër dëshmuese.

Përfundimisht, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja M.Llnuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavourshëm dhe të pabarabartë, në lidhje me pretendimet e parashtuara në ankesë. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavourshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses M.Ll , për shkak të “*gjendjes arsimore*” dhe “*moshës*” nga ana e subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa: z. A.S , Kryetar i Bashkisë Cërrik, z. F.D, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Cërrik dhe znj. M.Xh , Drejtore e Burimeve Njerëzore, Bashkia Cërrik.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja arsimore, mosha
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim